

Interview by Ermir Hoxha

In: "Korrieri" 23.2.2009 <http://www.korrieri.com/Kulture/778.html>

O këngët tuaja



Intervistë me Ekehard Pistrick, etnomuzikologun gjerman që gjurmon këngë të vjetra të Shqipërisë së Jugut

Që nga viti 2004, etnomuzikologu gjerman Ekehard Pistrick i është dedikuar me pasion zbulimit të mistereve të këngës shumëzërëshe të Shqipërisë së Jugut. Në vitin 2008, bazuar në punën e vazhdueshme të terrenit në Shqipërinë e Jugut dhe kufirin greko-shqiptar, ai botoi edhe librin e tij "Zëra të fshehur", mbi vazhdimësinë dhe transformimin e këngës popullore të Shqipërisë së Jugut. Ekehard Pistrick ka kryer studimet e larta për Histori, dhe më tej për Histori të Artit dhe Etnomuzikologji. Ai është aktualisht lektor në Universitetin e Halles në Gjermani, por ka qenë i ftuar si lektor edhe në universitetin e "Manchester Metropolitan" në Angli dhe "Olomouc University" në Çeki. Kërkimet komperative etnomuzikologjike që ai ka kryer në Kamboxhia, Marok e Siri, Bullgari, Greqi e Maqedoni i kanë mundësuar atij ta lokalizojë këngën shqiptare në konstruktin e kulturës mesdhetare. Ai ka qenë, ndër të tjera, edhe një promovues i zellshëm i kulturës shqiptare, veçanërisht të polifonisë si trashëgimi kulturore nën mbrojtjen e UNESCO-s, duke luajtur kësaj një rol aktiv në organizimin e koncerteve me polifoni shqiptare gjatë viteve 2005 dhe 2009, artikujve gazetareskë dhe shkencorë për njohjen e kësaj tradite dhe programeve të ndryshme në media të huaja. Për këtë ai ka marrë edhe çmimin e medias "Sachsen-Anhalt 2006", si edhe çmimin e "Siemens Cultural Foundation" në vitin 2005. Aktualisht ai është duke përfunduar tezën e tij mbi këngët shqiptare të kurbetit nën supervizionin e etnomuzikologut të njohur francez, Bernard Lortat-Jacob, një specialist në polifoninë shqiptare dhe autor i filmit dokumentar "Chant du pays perdu" (Kënga e atdheut të humbur) mbi këngën polifonike çame.

-Përse zgjodhët t'ia kushtoni jetën tuaj profesionale kësaj fushe studimi? Duhet të ketë qenë një rrugë e gjatë. Ka qenë një pasion i hershëm te ju, apo një risi që e sjell vetë koha që jetojmë?

“Po, ka qenë një rrugë e gjatë më shumë se dhjetëvjeçare. Studimet e mia i fillova për Histori në universitetin e Halles në Gjermani. Por më pas kam kuptuar se studimet në histori deri në njëfarë mase janë statike dhe jo të lidhura, sërish deri në njëfarë mase, me botën reale, me jetën e përditshme të njerëzve. Ndaj vendosa më pas që studimet e mia t’i vazhdoja në Historinë e Artit, për të zbuluar lidhjet midis koncepteve estetike të njerëzve në kohë dhe hapësira të ndryshme dhe sesi ato shprehen e ndryshojnë në rrethanat sociale të ndryshme. Në këtë fushë, që në fillimet e studimeve, gjeta një lloj dinamizmi që më fashinoi që “në shikim të parë”, në qoftë se mund të them kështu. Megjithatë, unë kam studiuar në të tre drejtime në të njëjtën kohë, pa e braktisur degën e mëparshme. Dhe kjo rezultoi të ishte tepër e frytshme, sepse më lejoi të shoh përtej kufijve të disiplinave të veçuara. Arti pa historinë nuk mund të ketë kuptim. Po kështu, muzika pa historinë nuk mund të ekzistojë. Kjo për mua do të thoshte se duhej kontekstualizuar çdo përjetim dhe mënyra më e mirë për ta bërë këtë ishte të studiohej fenomeni në atë moment dhe në atë vend që ai shfaqej”.

-Konkretisht, çfarë do të thotë kjo nevojë për kontekstualizim për punën e një etnomuzikologu?

“E përkthyer në termat e punës së një etnomuzikologu, kjo do të thotë se kënga është e plotë kur ajo është e pashkëputur nga konteksti social, nga njerëzit që e përcjellin atë dhe nga jeta e tyre e përditshme. Kjo nuk është e vërtetë vetëm për muzikën. Nëse vëren me kujdes pikturën e Gaugin, shumë kuptime aty rezultojnë se janë të fshehura dhe kështu ndodh edhe kur përqendrohesh te performanca muzikore. Duhet të shkosh thellë e më thellë, në emocionet, në biografite individuale, në formësimet historike të kohës dhe hapësirës, për të arritur të kapet kuptimi që kjo performance ka në momentin aktual, momentin e dhënë. Dija është e fragmentarizuar, asnjëherë e plotë. Asnjëherë nuk e njih një piktor nga një pikturë e vetme. Po kështu, asnjëherë nuk e njih një traditë muzikore nga një performance e vetme. Mënyra për ta zbuluar atë të plotë është vetëm një: duke ndjekur një rrugë të thepët dhe të gjatë, por plot me surpriza, në jetët reale të njerëzve. Kjo është edhe arsyeja se përse e quaj librin tim “Zërat e fshehur”.

-Por muzika tradicionale e Shqipërisë është e njohur për të gjithë ne, apo jam gabim. Si mund të jetë “e fshehtë”? Përse e përdorni këtë fjalë?

“Këtu kemi të bëjmë me një koncept që duhet sqaruar: unë nuk flas për muzikën tradicionale që gjejmë në radio e televizione, pra nuk flas për muzikën e mediatizuar. Në shkencën tonë këtë të fundit ne e quajmë “folklor”. Por flas për muzikën reale, muzikën e njerëzve të vërtetë në jetën e tyre të vërtetë, pra muzikën e lidhur me një kontekst specifik social, me një vend specifik ku ajo performohet si një shprehje e personalitetit të këtyre njerëzve dhe ku i shërben ndërtimit lokal të identitetit të tyre. Kjo muzikë reale gjendet ende në Shqipëri. “E fshehur” mund të interpretohet në dy mënyra në këtë rast: së pari, mund të interpretohet në terma të kuptimit të fshehur të praktikës muzikore në vetvete. Së dyti, në terma të vështirësive në gjetjen dhe zbulimin e një muzike të tillë me baza lokale në Shqipërinë e sotme me një shoqëri në transformim, ose më tepër sesa kaq, me një shoqëri që i përmbysi vlerat e saj në emër të rinegocimit të tyre. Në këtë kuptim, kjo lloj muzike është ende e fshehur në Shqipërinë e sotme”.

-Meqenëse folët për Shqipërinë si një vend në tranzicion, si e keni gjetur atë në fillim kur erdhët këtu?

“Për herë të parë përjetimet e mia ndaj Shqipërisë si një etnomuzikolog kanë qenë shumë ambige. Në të njëjtën kohë vëreja një mbijetesë të kulturës popullore dhe një dinamizëm këtu.

Por në të njëjtën kohë gjeja edhe një qasje të paorganizuar, gati një lloj fiksacioni ndaj modernitetit. Them mbase, se kjo e fundit ka qenë edhe e udhëhequr nga shembujt e imponuar dhe nga imitacionet e përcipta që pasonin të vendeve të afërta evropiane. Edhe njerëzit i kam gjetur midis këtyre dy ekstremeve, tepër konfuzë dhe të paorientuar. Por ende Shqipëria ishte tepër e afërt me background-in tim kulturor evropian, shumë më e afërt sesa përjetimet që kam pasur në vende të tjera, si në Marok për shembull. Marokun do ta quaja një shokim kulturor për mua si një qytetar evropian, një shokim kulturor multishqisor. Në Shqipëri mund të gjeja aspekte jetësore të njohura për mua, plus që mund të gjeja edhe gjëra që tashmë kanë humbur në shoqërinë perëndimore, të dominuara nga individualizmi, për shembull, vlerën e solidaritetit njerëzor që shprehet aq bukur kur njerëzit këndojnë dhe kërcëjnë së bashku”.

-Librin tuaj do ta quanit një libër shkencor, apo një libër letrar?

“Libri im është një homazh për të gjithë ata këngëtarë që kam takuar. Jo në sensin shkencor, por në atë letrar. Për mua këta njerëz nuk kanë qenë informatorë, të cilët shfrytëzohen për informacion. Unë kam parë në fytyrat e tyre, të ravijëzuara nga vuajtja dhe lufta për mbijetesë, dhe kam kuptuar se këta njerëz kanë përjetimet dhe emocionet e tyre individuale, kanë një histori pas shpine. Ata nuk janë atje që t’u përgjigjen pyetjeve të mia, por të tregojnë një histori, historitë e jetës së tyre. Kështu që detyra ime aty është të dëgjoj, dhe ajo që rrjedh nga ky dëgjim i imi, është libri im”.

-Si e shpreh veten një këngë kolektive historike te përjetimet e një individi?

“Çdo performancë e një kënge ka një ngjyrë individuale që bazohet tek emocioni, rivitalizimi i kujtesës dhe te marrëdhënia e këngëtarëve me studiuesin. Për shembull, le të krahasojmë këngën e Ismail Qemalit në skenën e Festivalit të Gjirokastrës, nëse e dëgjojmë atje, me një nga regjistrimet e para të etnomuzikologjisë në Shqipëri nga Stoskmann - Sokoli, apo ta krahasojmë me atë që kam dëgjuar vetë në festën e Baba Tomorit në 2008-ën. Megjithëse teksti është po i njëjti, kënga është tërësisht e ndryshme. Përse? Sepse kuptimi dhe mesazhi i këngës ka ndryshuar. Kënga nuk është një “e pafajshme”. Ajo mund të instrumentalizohet, mund të jetë një vegël për pushtetin. Kujtoni se çfarë ka ndodhur në periudhën e diktuarës që përjetuat. Kënga mund të jetë një vijim i një bisede gojore (ajo që ju shqiptarët e quani “muhabet”) mes miqsh. Kënga mund të jetë një shprehje e dhimbjes dhe e gëzimeve. Ose ajo mund të jetë vetëm një objekt estetik, siç ndodh në festivale, për shembull. Etnomuzikologjia duhet të përfshihet në këtë proces shumëdimensional. Për mua etnomuzikologu duhet të mos mbetet një vëzhgues i thjeshtë, por të marrë pjesë, të mësojë edhe të këndojë, të bashkohet me gëzimin dhe hidhërimin e njerëzve”.

-Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

“Për momentin unë do të vazhdoj kërkimet e mia mbi krahasimin e mënyrave të ndryshme të kënduarit në Mesdhe, në kuadër të projektit ‘Përfaqësime zanore dhe vizuale të identitetit shqiptar’, projekt kërkimor nga Universiteti i Halles në Gjermani. Për më tepër, shpresoj të tërheqim interesin e njerëzve ndaj muzikës tradicionale shqiptare në një tur koncerti në mars të këtij viti nëpër Evropë. Ky tur për herë të parë bashkon muzikën tradicionale shqiptare përmes grupit “Jonianët” të Sarandës, dhe muzikën bashkëkohore të realizuar nga këngëtarja zvicerano-shqiptare e etno-xhazit, Elina Duni dhe grupi i saj. Për më tepër, kam dëshirë që të ngremë ura muzikore, përmes prodhimit të muzikës rituale me këngëtarën ukrainase Mariana Sadovska dhe me grupin shqiptar “Jonianët”, duke treguar se traditat muzikore që ne mendojmë se janë kaq larg njëra-tjetrës, kanë të përbashkëtat e tyre në strukturë dhe kanë si background të njëjtat koncepte mendore”.

-Ju falënderojmë për intervistën dhe shpresojmë që së shpejti do të kemi rastin ta kemi libri juaj të përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

“Ju faleminderit juve”!